

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje me nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), dhe neni 15 paragrafi 1 alineja 7 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-435/1 nga data 29.08.2014, e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë me numër nr. 02-5747/6 nga data 21.11. 2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e tij të 19-të, të mbajtur më 21.11. 2014, miratoi:

RREGULLORE PËR RAJONET E EMETIMIT TË SHËRBIMEVE PROGRAMORE TË RADIOS DHE TELEVIZIVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen rajonet e emetimit të shërbimeve programore të radios dhe televizionit

Rajon për emetim është një tërësi e kufizuar gjeografike në të cilën emetohet ndonjë shërbim programor i radios apo ai televiziv.

Neni 2

Rajoni i emetimi, sipas nivelit të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë të shërbimeve programore të radios dhe televizionit mund të jetë: Shtetëror (tërë territori i Republikës së Maqedonisë), rajonal (një rajon i caktuar) ose lokal (një vendbanim i caktuar me rrethimin e ngushtë).

II. MJETET TEKNIKE PËRMES TË CILËVE SIGUROHET EMETIMI I RADIOS DHE AI TELEVIZIV

II. Për emetim televiziv

Nivel shtetëror

Neni 3

Emetimi i shërbimit programor televiziv në nivel shtetëror mund të realizohet përmes:

- resurseve të kufizuara - multipleksit digjital terestrial;
- Rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara ose përmes
- satelitit.

Gjatë sigurimit të emetimit televiziv në nivel shtetëror përmes resurseve të kufizuara – multipleksi digjital terestrial, radiodifuzeri është i obliguar që të sigurojë mbulim me sinjal të së paku 80% të popullsisë së Republikës së Maqedonisë.

Niveli rajonal

Neni 4

Emetimi i shërbimit programor televiziv në nivel rajonal mund të realizohet përmes:

- resurseve të kufizuara - multipleksit digjital terestrial ose;
- rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara;

Gjatë sigurimit të emetimit televiziv në nivel rajonal përmes resurseve të kufizuara – multipleksi digjital terestrial, radiodifuzeri është i obliguar që të sigurojë mbulim me sinjal të së paku 80% të popullsisë në rajonin përkatës.

Niveli lokal

Neni 5

Emetimi i shërbimeve programore televizive në nivel lokal mund të bëhet vetëm përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara.

II. 2 Radio emetimi

Nivel shtetëror

Neni 6

Emetimi i shërbimit programor të radios në nivel shtetëror mund të realizohet përmes:

- Radiofrekuencave;
- resurseve të kufizuara - multipleksit digjital terestrial;
- Rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara ose përmes;
- satelitit.

Gjatë sigurimit të emetimit të radios në nivel shtetëror përmes resurseve të kufizuara – radiofrekuencave ose multipleksit digjital terestrial, radiodifuzeri është i obliguar që të sigurojë mbulim me sinjal të së paku 80% të popullsisë së Republikës së Maqedonisë.

Niveli rajonal

Neni 7

Emetimi i shërbimit programor të radios në nivel rajonal mund të realizohet përmes:

- Radiofrekuencave;
- resurseve të kufizuara - multipleksit digjital terestrial ose;
- rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara;

Gjatë sigurimit të emetimit të radios në nivel rajonal përmes resurseve të kufizuara – radiofrekuencave ose multipleksit digjital terestrial, radiodifuzeri është i obliguar që të sigurojë mbulim me sinjal të së paku 80% të popullsisë në rajonin përkatës.

Niveli lokal

Neni 8

Emetimi i shërbimit programor të radios në nivel lokal mund të realizohet përmes:

- Radiofrekuencave ose përmes
- rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara.

III. RAJONET E EMETIMIT

III. 1 EMETIMI I RADIOS DHE TELEVISIONIT NË NIVEL RAJONAL

Neni 9

Si rajone në nivel rajonal për të cilat jepet leje për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive konsiderohen zonat e shpërndarjes të përcaktuara në Planin Gjeneva 06 që është pjesë e Konferencës Rajonale të radiokomunikimit për planifikimin e shërbimit digjital radiodifuziv në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në hapësirat radiofrekuentuese 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) në të cilën është anëtarësuar Republika e Maqedonisë, përveç zonës së shpërndarjes D1- Crn Vrv e cila përbëhet prej dy rajoneve të emetimit Shkup dhe Veles, respektivisht rajone në nivel rajonal Shkup dhe rajone të nivelit rajonal Veles. Pjesa e nivelit rajonal Shkup i përmban qytetin e Shkupit dhe komunat Çuçer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopište. Pjesa e nivelit rajonal Veles i përmban komunat e Velesit, Sveti Nikollës, Llozovës, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe pjesë të komunës së Kavadarit.

Pjesët në nivel rajonal janë të pasqyruara në Shtesën nr. 1 të kësaj Rregullore.

III. 2 EMETIMI RADIO DHE TELEVIZIV NË NIVEL LOKAL PËRMES RRJETIT PUBLIK TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Neni 10

Rajonet e emetimit në nivel lokal përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik, janë të pasqyruara në Shtesën nr.2 të kësaj Rregullore, edhe atë:

- Komuna e Kumanovës, Komuna e Likovës dhe Komuna e Nagoriçit të Vjetër;
- Komuna e Kriva Pallankës dhe Komuna e Rankovcës;
- Komuna e Koçanit, Komuna e Vinicës, Komuna e Çeshinovës-Obleshevës dhe Komuna e Zërnovcit;
- Komuna e Dellçevës dhe Komuna e Makedonska Kamenicës;
- Komuna e Kratovës dhe Komuna e Probishtipit;
- Komuna e Shtipit dhe Komuna e Karbincit;
- Komuna e Berovës dhe Komuna e Pehçevës;
- Komuna e Radovishtë dhe Komuna e Konçes;
- Komuna e Strumicës, Komuna e Vasilevës, Komuna e Bosillovës dhe Komuna e Novo sellës;
- Komuna e Gjevgjeliës, Komuna e Vallandovës, Komuna e Bogdancit dhe Komuna e Dojranit;
- Komuna e Kavadarit, Komuna e Negotinës, Komuna e Rosomanit dhe Komuna e Demir Kapisë;
- Komuna e Velesit, Komuna e Çashkës dhe Komuna e Gradskos;
- Komuna e Sveti Nikollës dhe Komuna e Llozovës;
- Komuna e Prilepit, Komuna e Dollnenit dhe Komuna e Krivogashtanit;
- Komuna e Krushevës dhe Komuna e Demir Hisarit;
- Komuna e Manastirit, Komuna e Mogillës, Komuna e Novacit dhe Komuna e Resnjes;
- Komuna e Ohrit dhe Komuna e Debarcës;
- Komuna e Strugës dhe Komuna e Vevçanit;
- Komuna e Dibrës, Komuna e Qendrës Zhupë dhe Komuna e Mavrovës dhe Rostushës;
- Komuna e Kërçovës, Komuna e Pllasnicës dhe Komuna e Makedonski Brodit;
- Komuna e Tetovës, Komuna e Tearcës, Komuna e Jegunovcit, Komuna e Zhelinës dhe Komuna e Bërvenicës;
- Komuna e Gostivarit, Komuna e Vrapçishtit dhe Komuna e Bogovinës.

III.3 RADIO EMETIMI NË NIVEL LOKAL PËRMES RADIOFREKUENCAVE

Neni 11

Rajonet e emetimit në nivel lokal përmes radiofrekuencave, janë të pasqyruara në Shtesën nr.3 të kesaj Rregullore, edhe atë:

- Komuna e Berovës
- Komuna e Manastirit
- Komuna e Bogdancit
- Komuna e Vallandovës
- Komuna e Velesit
- Komuna e Vinicës
- Komuna e Gjevgjelisë
- Komuna e Gostivarit
- Komuna e Dibrës
- Komuna e Dellçevës
- Komuna e Demir Kapisë
- Komuna e Demir Hisarit
- Komuna e Kavadarit
- Komuna e Kërçovës
- Komuna e Koçanit
- Komuna e Kratovës
- Komuna e Kriva Pallankës
- Komuna e Krushevës
- Komuna e Kumanovës
- Komuna e Makedonska Kamenicës
- Komuna e Makedonski Brodit
- Komuna e Negotinës
- Komuna e Ohrit
- Komuna e Pehçevës
- Komuna e Prilepit
- Komuna e Probishtipit
- Komuna e Radovishit
- Komuna e Resnjës
- Komuna e Sveti Nikollës
- Komuna e Strugës
- Komuna e Strumicës
- Komuna e Tetovës
- Komuna e Shtipit
- Komuna e Bosillovës
- Komuna e Bërvenicës
- Komuna e Vasilevës
- Komuna e Vevçanit
- Komuna e Vrapçishtit
- Komuna e Gradskos
- Komuna e Debarcës
- Komuna e Dojranit
- Komuna e Dollnenit
- Komuna e Zhelinës
- Komuna e Zërnovcit
- Komuna e Ilindenit
- Komuna e Jegunovcit
- Komuna e Bogovinës

- Komuna e Karbincit
- Komuna e Konçes
- Komuna e Krivogashtanit
- Komuna e Likovës
- Komuna e Llozovës
- Komuna e Mavrovës dhe Rostushës
- Komuna e Mogillës
- Komuna e Novacit
- Komuna e Novo Sellës
- Komuna e Pllasnicës
- Komuna e Rankovcit
- Komuna e Rosomanit
- Komuna e Nagoriçit të vjetër
- Komuna e Tearcës
- Komuna Qendër Zhupë
- Komuna e Çashkës
- Komuna e Çeshinovës - Obleshevës

II. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 12

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore pushon vlefshmëria e Rregullores për përcaktimin e rajoneve të emetimit përmes shërbimeve programore televizive të rrjetit publik të komunikimit në nivel lokal, nr. 01-2270/1 nga data 18.05.2013

Neni 13

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

Nr. 01-5778/1


21.11.2014
Shkup

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele**

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Shtesa 1: Rajonet e emetimit në nivel rajonal



Shtesa 3: Rajonet e emetimit në nivel lokal përmes radiofrekuencave

